



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr 28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 40 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të nenit 12,14 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 9, 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, Shkresës përcjellëse të MAPL-së Nr.020-831/11 të datës 05.08.2019, Shkresës përcjellëse të Ministrisë së Shëndetësisë Nr.05-4069 të datës 30.07.2019 si dhe Njoftimit : Rivlerësimi i Grantit të Performancës Komunale të Ministrisë së Pushtetit Lokal Nr.454-666/11 të datës 28.12.2020 Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me datë ____2021 të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

**PËR SHFUQIZIMIN NE VENDIMIT 15NR.500-48448 I DATËS 30.07.2019 PËR
MIRATIMIN E STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT TË KOMUNËS SË
LIPJANIT PËR KUJDES PARËSOR SHËNDETËSOR**

Neni 1

1. SHFUQIZOHET, Vendimi 15Nr.500-48448 për miratimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Komunës së Lipjanit për kujdes parësor shëndetësor i datës 19.07.2019 si dhe Strategjia dhe Plani i veprimit i Komunës së Lipjanit për Kujdes Parësor Shëndetësor (2020-2024) si pjesë përbërëse e Vendimit .

Neni 2

OBLIGOHET, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale të zhvillojë paraprakisht konsultimet e nevojshme me Ministrinë e Shëndetësisë rreth procedurës së

nxjerrjes dhe miratimit të dokumenteve strategjike të komunës për kujdes parësor shëndetësor në përputhje me politikat nacionale për KPSH.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdeset Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim-vendimi është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008.

Komuna e Lipjanit ka miratuar Vendimin 15Nr.500-48448 të datës 19.07.2019 për miratimin Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Komunës së Lipjanit për kujdes parësor – shëndetësor 2020-2024 dhe i njëjti është dërguar për vlerësim të ligjshmërisë brenda afatit të përcaktuar ligjor në MAPL ndërsa MAPL ka dërguar shkresën përcjellëse për kontestim të ligjshmërisë së aktit në ditën e 17 pas kalimit të afatit ligjor.

Ministria e Shëndetësisë në Shkresën përcjellëse nr.05-4069 të datës 30.07.2019 ka theksuar në mes tjerash se të gjitha planet operative të komunave në fushën e shëndetësisë duhet të jenë përputhje me politikat nacionale për KPSH dhe që në pajtim me Strategjinë sektoriale të shëndetësisë 2017-2021 pas miratimit të Planit Strategjik të KPSH nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Udhëzimin Administrativ 07-2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit , Komunitat mund të nxjerrin dokumentet strategjike për zhvillim institucional.

Shfuqizimi i Vendimit të cekur në këtë periudë bëhet pasi me datë 28.12.2020 Ministri i Ministrisë së Pushtetit Lokal i ka dërguar Kryetarit të Komunës Njoftimin për Rivlerësimin e Grantit të Performancës Komunale me të cilin është vendosur që t'iu mundësohet Komunave një afat shtesë për plotësimin e kushtit minimal 2 që nënkupton "Komunitat duhet të kenë respektuar obligimin ligjor për t'i rishikuar aktet komunale të vlerësuara si të kundërligjshme nga organet mbikqyrëse"

Në Njoftimin e cekur gjithashtu theksohet se Komunitat të cilat deri me datën 22 janar 2021 rishikojnë aktet e vitit 2019 që konsiderohen të kundërligjshme nga autoriteti mbikqyrës do të konsiderohet se kanë përmbushur kushtin minimal 2 .

Duke u bazuar në nevojën e Komunës për mbështetje financiare pasi Granti i performances Komunale është një nga skemat kryesore të mbështetjes së qeverisjes lokale, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi

1Nr. 500-624

Lipjan, më 06.01 2021

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPIAN

Në mbështetje të neneve 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 18. 07. 2019, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR KUJDES PARËSOR-SHËNDETËSOR (2020-2024)

Neni 1

MIRATOHET, Strategjia dhe Plani i veprimit të Komunës së Lipjanit për Kujdes Parësor-Shëndetësor (2020-2024).

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Strategjia dhe Plani i veprimit i Komunës së Lipjanit për Kujdes Parësor-Shëndetësor (2020-2024).

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.


Neni 4


Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

15Nr. 500-48448

Lipjan, më 19. 07. 2019

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN





Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministristvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, Datë: 30.07.2019

Nr.020-831/3

Për: Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit

Lënda: Shkresë përcjellëse

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar, Vendimin Nr.500-48448 për miratimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Komunës së Lipjanit për kujdes parësor -shëndetësor, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit dhe nënshkruar nga Kryesuesi i KK të Lipjanit, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Duke u bazuar në nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2016 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me datë 22.07.2019, ka përcjellë aktin e lartshënuar për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrinë e Shëndetësisë.


Bashkangjitur gjeni Raportin nga MSH lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë.

Me respekt,

Rozafa Ukimeraj

Sekretarë e Përgjithshme e MAPL-së

Kopje: Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Arkivit të MAPL-së



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA / GOVERNMENT
Ministria e Shendetesise / Ministry of Health
Nr. 27
Data: 29.07.2019
Prishine / Pristina

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Departamenti Ligjor / Pravni Departament / Legal Department

Ministria e Administrimit të Fshatit Lokal
Ministry of Local Government Administration
Data: 29.07.2019
Nr. 112/2019
Prishine / Pristina

DATE/A:	29/07/2019
PER/ZA/TO:	Znj. Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL
Cq/Cc	Z. Uran Ismaili, Ministër i Shëndetësisë
PËRMES/PREKO/THROUGH	Dr. Naim Haxhiqi, Sekretar i Përgjithshëm
NGA/OD/FROM:	Aferdita Hoxha, U.d. Udhëheqës Departamenti Ligjor
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim të ligjshmërisë së Vetëqeverisje lokale aktin komunal në vijim

E nderuara znj. Ukimeraj,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyres së Kryeministrit dhe Ministrave, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Shëndetësisë ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/I-040 për Vetëqeverisje lokale aktin komunal në vijim:

Vendimin nr.500-48448 për miratimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Komunës së Lipjanit për Kujdes parësor – shëndetësor (2020-2024) i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit dhe nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
I miratuar me 19/07/2019.
I dërguar për shqyrtim në MSH, me datë: 24/07/2019

Ministria e Shëndetësisë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislaclonit në fuqi me Ligjin për Shëndetësi nr. 04/L 125, Strategjinë Sektoriale të Shëndetësisë 2017 – 2021 dhe Udhëzimin Administrativ 07-2018- Për Planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit.

Mos pajtueshmëritë të aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim.
1.	Vendimin nr.500-48448 për miratimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Komunës së Lipjanit për Kujdes parësor – shëndetësor (2020-2024) i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit dhe nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Lipjanit	Ligji për Shëndetësi nr. 04/L 125, neni 8 dhe 18 përcakton se politikat shëndetësore hartohen nga Ministria e Shëndetësisë përfshirë edhe kujdesin parësor shëndetësor. Në kuadër të Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë 2017 – 2021, Ministria e Shëndetësisë ka themeluar grupin punues për hartimin e planit strategjik për Kujdes Parësor Shëndetësor. Pjesë e grupit punues është Kryesuesja e Kolegjiumit për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Rrjedhimisht të gjitha Planet operative të Komunave në fushën e shëndetësisë duhet të jenë në përputhje me politikat nacionale për KPSH. Marrë parasysh këtë në pajtim me Strategjinë sektoriale të shëndetësisë 2017 – 2021, pas miratimit të Planit Strategjik të KPSH nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, dhe Udhëzimin Administrativ 07-2018- Për Planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit, Komuna mund të nxjerrin dokumentet strategjike për zhvillim institucional.

Ministria e Shëndetësisë, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Me respekt,